



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS**  
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA - KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL



# **BULETINI** **MUJOR**

**Prishtinë, 2025**

**Ky edicion i Buletinit pasqyron  
aktivitetet e KPK-së për muajin janar të vitit 2025**

## **Drejtori e Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, z. Sami Istrefi, mbajti një ligjëratë në Fakultetin Juridik për rëndësinë e administratës në mbështetje të punës së KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit**

Prishtinë, 10 janar 2024 - Në kuadër të aktiviteteve informuese dhe njohëse për rolin dhe misionin e sistemit prokurorial në Republikën e Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (SKPK), z. Sami Istrefi, mbajti një ligjëratë të hapur para studentëve dhe stafit akademik të Fakultetit Juridik të Universitetit “Ukshin Hoti”, në Prizren, i shoqëruar nga anëtari i KPK-së, Prof.Ass. Dardan Vuniqi, ku i pritën në takim Prodekani i Fakultetit Juridik, Prof. asoc. dr. Halim Bajraktari, Shefi për Mësim i Programit Master, Prof. asoc.dr. Enver Buçaj dhe Shefi për Mësim i Programit Bachelor, Ass. Milot Krasniqi.



Qëllimi i ligjëratës së sotme ishte informimi i studentëve për rolin, organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit Prokurorial të Kosovës, me ç’rast Drejtori Istrefi nënvizoi rëndësinë e administratës në mbështetjen e punës së Këshillit Prokurorial dhe prokurorive të vendit tonë.

Ndër të tjera, z. Istrefi, foli para të pranishmëve për organizimin strukturor të administratës dhe ndarjen e detyrave, rëndësinë e koordinimit efikas, mbështetjen e ofruar për proceset vendimmarrëse dhe garantimin e funksionimit të

përditshëm të sistemit, duke informuar studentët për mundësinë e angazhimit të tyre profesional në Këshillin Prokurorial dhe në institucionet e Prokurorit të Shtetit, përmes pjesëmarrjes së tyre në punët praktike.



Ligjërata e z. Sami Istrefi ishte interaktive dhe studentët e Fakultetit Juridik shprehën interesim të madh gjatë ligjërimit të tij, duke parashtruar pyetje të ndryshme për diskutim dhe parashihet që edhe ligjërata të tjera të mbahen përgjatë këtij viti.

## U.D. Kryeprokurori i Shtetit, Kryesuesi i KPK-së dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale vizitojnë Prokurorinë Themelore në Pejë

Pejë, 15 janar 2025 – Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, z. Blerim Isufaj, kanë zhvilluar vizitë zyrtare në Prokurorinë Themelore në Pejë ku janë pritur në takim nga Kryeprokurorja e kësaj prokurorie, znj. Lumturije Vuçetaj.



Krerët e sistemit prokurorial kanë uruar znj. Vuçetaj për zgjedhjen e saj në krye të Prokurorisë Themelore në Pejë, ku gjatë këtij takimi ata kanë pasur diskutime të frytshme për çështje të ndryshme profesionale, duke i ofruar asaj mbështetje dhe përkrahje të plotë në arritjen e objektivave.

Gjithashtu, ata kanë shprehur vullnetin e tyre institucional që brenda mandatit dhe kompetencave ligjore të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë ngushtë dhe në mënyrë efektive me Prokurorinë Themelore në Pejë dhe Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës në funksion të forcimit të sundimit të ligjit.

Ndërkaq, Kryeprokurorja e Prokurorisë Themelore të Pejë, znj. Lumturije Vuçetaj, falënderoi krerët e sistemit prokurorial për vizitën, mbështetjen dhe përkrahjen e ofruar si dhe u zotua që bashkërisht do bëjnë më të mirën e mundshme për sundimin e ligjit dhe arritjen e objektivave të parapara në planin e punës në mandatin e saj katër vjeçar.



## Mbahet takimi i radhës për hartimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2025-2027

Prishtinë, 16 janar 2025 –Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), përkatësisht anëtarët e Grupit punues për hartimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2025-2027, të udhëhequr nga Zëvendësja e Kryesuesit të KPK-së, znj. Jehona Grantolli, mbajti një takim për të vlerësuar ecurinë e hartimit të tij, i cili mbështetet nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. Të pranishëm në këtë takim ishin përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane në Prishtinë dhe Zyrës së BE-së.



Më këtë rast, znj. Jehona Grantolli, falënderoi grupin punues dhe partnerët ndërkombëtarë për ndihmën e ofruar në hartimin e draftit bazik, sidomos Ambasadën Amerikane, duke theksuar se janë pajtuar për t'i trajtuar objektivat e caktuar strategjike në brendësinë e këtij drafti dhe çështjet e identifikuara për veprimtarinë trevjeçare të sistemit prokurorial.

Edhe Kryesuesi i KPK-së, z. Ardian Hajdaraj dhe Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, gjatë fjalës së tyre, nënvizuan rëndësinë e madhe të Planit strategjik, duke kërkuar që të dalin në pah vlerat e tij, të cilat kanë të bëjnë me profesionalizmin, integritetin, etikën dhe pavarësinë në punë të sistemit prokurorial.

Në përfundim të takimit të sotëm, u tha që së bashku me përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë do të mbahen takime të tjera gjer në finalizimin e këtij plani, i cili do të jetë në mbështetje të sundimit të ligjit, ruajtjes së pavarësisë, forcimit të transparencës dhe llogaridhënies së sistemit prokurorial.

## Mbahet takimi i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 20 janar 2025 – Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, mbajti takimin e parë të këtij viti, në të cilin trajtoi pikat e parapara të rendit të ditës.

Më këtë rast, anëtarët e këtij Komisioni, pasi kanë pranuar nga grupet punuese dy draftet fillestare - atë të Rregullores për Themelimin dhe Funkcionimin e Ekipeve të Përbashkëta Hetimore, si dhe atë për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Shtesat dhe Kompensimet për të Punësuarit në Sistemin Prokurorial, vendosën që të njëjtat të publikohen për dëgjim publik në faqen zyrtare të KPK-së.



Siç u tha në këtë takim, pas marrjes së komenteve eventuale gjatë afatit të paraparë dhe shqyrtimit të tyre për inkorporim, si dhe finalizimit të drafteve, ato do të dërgohen për miratim në njërin nga takimet e KPK-së.

## Mbahet Takimi i 261-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 23 janar 2025 – Këshilli I Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 261-të me radhë, me ç’rast fillimisht z. Hajdaraj uroi kryeprokurorët e rinj për zgjedhjen e tyre në krye të prokurorive të vendit, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë për të zbatuar objektivat e përbashkëta. Vendimet që mori KPK-ja në takimin e sotëm janë si vijojnë:

-Miratoi në tërësi Raportin e punës së Prokurorisë së Apelit për vitin 2024, kurse për raportet vjetore të punës së Prokurorisë Speciale, Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në Ferizaj, në Pejë, në Gjilan dhe në Mitrovicë obligoi kryeprokurorët përkatës që në afat prej shtatë (7) ditësh të plotësojnë raportet përmblendhëse me statistikat e raporteve individuale të prokurorëve dhe realizimin e normave të tyre orientuese, kurse Prokurorinë Themelore në Prizren e obligoi që të plotësojë raportin përmblendhës me numrin e rasteve të procedurave për konfiskim të aseteve të fituara me vepra penale, si dhe të njëjtat raporte t’i dorëzojnë në Zyrën e Kryesuesit të KPK-së dhe



-Anëtarët e KPK-së u njoftuan nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit për Planin e Personelit Administrativ për vitin 2025.



## Kryesuesi Hajdaraj priti në takim Koordinatorën Nacionale për Zgjedhje nga radhët e sistemit prokurorial, znj. Laura Pula

Prishtinë, 28 janar 2025 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z. Ardian Hajdaraj, priti në takim Koordinatorën Nacionale për Zgjedhje nga radhët e sistemit prokurorial, prokuroren në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, znj. Laura Pula.

Fillimisht, Kryesuesi Hajdaraj përgëzoi Koordinatorën Pula dhe stafin e saj për gatishmërinë e treguar dhe angazhimin konsekuent përgjatë viteve të kaluara në mbrojtje të votës së qytetarëve dhe, njëkohësisht, i shprehu mbështetjen dhe përkrahjen e tij në këtë proces të zgjedhjeve nacionale në vendin tonë. “Zonja Pula keni mbështetjen tonë të plotë për trajtimin e secilit rast dhe i bashkohem ftesës dhe apelit tuaj që qytetarët t’i raportojnë rastet tek Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës, të cilët mund të kenë informata për cenimin e fshehtësisë së votës apo për çfarëdo veprimi tjetër i cili përbën vepër penale kundër të drejtës së votimit”, tha z. Hajdaraj.



Gjithashtu, znj. Pula njoftoi Kryesuesin Hajdaraj për planin operativ të institucionit të Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e votës së lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës në zgjedhjet nacionale, të cilat mbahen më 9 shkurt 2025. Kryesuesi Hajdaraj dhe Koordinatorja Pula janë pajtuar në takimin e sotëm që të gjitha aktivitetet të kenë në vëmendje moscenimin e procesit aktual zgjedhor dhe mbarëvajtjen e rregullt deri në përmbylljen e tij, përfshirë këtu edhe bashkëpunimin e afërt me institucionet e tjera ligjzbatuese dhe atyre që merren me administrimin e zgjedhjeve dhe shqyrtimin e rasteve zgjedhore.

## Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 29 janar 2024 – Komisioni për Administrim të Prokurorive, i kryesuar nga z. Jetish Maloku, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë edhe anëtarja e këtij komisioni, prokurorja Laura Pula, përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Prishtinë, z. Mats Persson dhe udhëheqësit e njësisë të SKPK-së.

Në pikën e parë është aprovuar drafti i analizës për numrin e nevojshëm të prokurorëve në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, draft ky, i cili do të dërgohet për miratim në njërin nga takimet e Këshillit Prokurorial.



Në vijim të takimit të sotëm është themeluar grupi punues për hartimin e modeleve të unifikuara të raportimit të punës njëvjeçare të prokurorive të vendit. Në përfundim është prezantuar përmbledhja e raportit të punëtorisë për zbatimin e SMIL-it dhe raporteve statistikore të gjeneruara nga SMIL-i dhe është theksuar nevoja e organizimit të një takimi me udhëheqësit e prokurorive të vendit për të diskutuar gjendjen aktuale dhe sfidat që kalojnë ato në fushën e administrimit të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve.

## Mbahet takimi i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 31 janar 2025 – Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë prokurori në ZKPSH, Bahri Hyseni dhe prokurori special në PSRK, Ilir Morina, si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, z. Sami Istrefi.

Me këtë rast, anëtarët e Komisionit për Çështje Normative aprovuan draftin e Raportit të punës për vitin 2024 dhe Planin e punës për vitin 2025.

